

KARTËMONEDHA 10000 LEKË

KONTROLLO VËRTETËSINË E KARTËMONEDHËS

PREK

Kjo kartëmonedhë është shtypur në letër prej pambuku dhe karakterizohet nga një tingëllim e konsistencë e veçantë.


- 1 Ndieje shtypin e ngritur në të dy faqet e kartëmonedhës, te vlera nominale, tekstet, portreti, flamuri dhe gramafoni. Ndiej vijat e shkurtra përgjatë anës së majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës, që përbëjnë elementin e njohjes nga personat me aftësi të kufizuara shikimi.

SHIKO

- 2 Portreti i Asdrenit, vlera nominale 10000 Lekë dhe simboli i stilizuar i shqiponjës bëhen të dukshme, kundrejt dritës.
- 3 Nga një shirit i ndërprerë, filli i sigurisë duket një vijë e errët e pandërprerë.

LËVIZ

- 4 Shiriti i argjendtë në të majtë, shfaq logon e Bankës së Shqipërisë, portretin e Asdrenit, vlerën nominale 10000 Lekë dhe librin me pendë.
- 5 Libri me pendë në cepin e sipërm djathtas ndryshon ngjyrë, nga e artë në të gjelbër, me një efekt dinamik të figurës majtas e djathtas.
- 6 Filli i sigurisë ndryshon ngjyrë nga e gjelbër në të purpurt.
- 7 Në faqen e pasme të kartëmonedhës, shiriti i shndritshëm në zonën qendrore shfaq të shkruar vlerën 10000 Lekë.



KARTËMONEDHA JONË E RE: E SIGURT DHE MODERNE

Banka e Shqipërisë vijon ta plotësojë serinë e re të kartëmonedhave shqiptare, me emetimin e prerjeve të reja me pamje e cilësi të përmirësuar, për t'iu përshtatur zhvillimeve të teknologjisë, duke i bërë ato më të sigurt dhe të besueshme për publikun.

Kartëmonedha 10000 Lekë hidhet për herë të parë në qarkullim, duke pasuruar kështu serinë e kartëmonedhave të reja me një prerje tërësisht të re, në përputhje me nevojat e ekonomisë shqiptare.



Për më shumë informacion, vizito www.bankofalbania.org